



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 154

Tiranë – E martë, 1 gusht 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 492, datë 19.7.2017	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Për plotësimin dhe detajimin e projektit të rikualifikimit urban të Pazarit të Ri, markatës së mishit, fruta-perimeve dhe sheshit “Avni Rustemi”” 7291
Urdhër i ministrit të Financave nr. 66, datë 15.6.2017	Për delegim kompetence..... 7293
Urdhër i ministrit të Financave nr. 67, datë 20.6.2017	Për delegim kompetence..... 7293
Urdhër i ministrit të Financave nr. 69, datë 29.6.2017	Për delegim kompetence..... 7293
Urdhër i ministrit të Financave nr. 71, datë 3.7.2017	Për delegim kompetence..... 7294
Urdhër i ministrit të Financave nr. 72, datë 3.7.2017	Për delegim kompetence..... 7294
Urdhër i ministrit të Financave nr. 75, datë 6.7.2017	Për delegim kompetence..... 7294
Urdhër i ministrit të Financave nr. 78, datë 12.7.2017	Për delegim kompetence..... 7295
Urdhër i ministrit të Financave nr. 82, datë 19.7.2017	Për delegim kompetence..... 7295
Urdhër i ministrit të Financave nr. 83, datë 19.7.2017	Për delegim kompetence..... 7296

Urdhër i ministrit të Financave nr. 84, datë 24.7.2017	Për delegim kompetence.....	7296
Urdhër i ministrit të Financave nr. 85, datë 25.7.2017	Për delegim kompetence.....	7296
Urdhër i ministrit të Financave nr. 86, datë 27.7.2017	Për delegim kompetence.....	7297
Urdhër i ministrit të Financave nr. 87, datë 27.7.2017	Për shfuqizimin e aktit nr. 16, datë 11.7.2017, “Për ndryshime në përbërjen e Këshillit Mbikëqyrës të “Agjencisë së Trajtimit të Kredive””	7297
Urdhër i ministrit të Financave nr. 89, datë 28.7.2017	Për delegim kompetence.....	7297
Urdhër i ministrit të Mjedisit nr. 251, datë 27.7.2017	Për delegim kompetence.....	7298
Njoftim i Ministrisë së Punëve të Jashtme nr. 10937, datë 26.7.2017	Mbi hyrjen në fuqi të disa marrëveshjeve ndërkombëtare.....	7298
Njoftim i Ministrisë së Punëve të Jashtme nr. 11211, datë 31.7.2017	Mbi hyrjen në fuqi të Marrëveshjes me Italinë	7299

**VENDIM****Nr. 492, datë 19.7.2017****PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “PËR PLOTËSIMIN DHE DETAJIMIN E PROJEKTIT TË RIKUALIFIKIMIT URBAN TË PAZARIT TË RI, MARKATËS SË MISHIT, FRUTA - PERIMEVE DHE SHESHIT “AVNI RUSTEMI””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 130/2016 “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë të paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Për plotësimin dhe detajimin e projektit të rikualifikimit urban të Pazarit të Ri, markatës së mishit, fruta - perimeve dhe sheshit “Avni Rustemi””.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “tokë truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 830 400 (tetëqind e tridhjetë mijë e katërqind) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 830 400 (tetëqind e tridhjetë mijë e katërqind) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Tiranë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronari i listës që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Tiranë.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



LLOGARITJET PARAPRAKE, PËR NJË SHITESË NË VKM-NË NR. 167, DATË 1.3.2017 “PËR PLOTËSIMIN DHE DETAJIMIN E PROJEKTIT TË RIKUALIFIKIMIT URBAN TË PAZARIT TË RI, MARKATËS SË MISHIT, FRUTA - PERIMEVE DHE SHESHIT “AVNI RUSTEMI””

EMËR ATËSI MBIEMËR	Z. K.	Nr. Pas.	Sip. e përgj. Truall	Sip. e prekur Truall	Çmimi për m ² Truall	Sip. e përgj. Objekt	Sip. e prekur Objekt	Kosto për m ² Objekt	VLERA Truall+Objekt në lekë	KONFIRMIM ZVRPP, TIRANË	SHËNIME
Suzana Mehmet Merja	8150	2/103 - N5	10	10	66,969	10	10	16,071	830,400	Shkresa nr. Prot. 7295/1, datë 10.3.2017	Njësi
			Shuma		10.00 m ²			10.00 m ²	830,400 lekë		

SHËNIM:

1. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, datë.3.2.2016.
2. Pasuria e prekur nga projekti konfirmohet nga ZVRPP-ja, Tiranë, me shkresën nr. Prot. 7295/1, datë.10.3.2017.



URDHËR
Nr. 66, datë 15.6.2017

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të neneve 28, 29 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Financave, zëvendësministrit të Ministrisë së Financave, z. Erjon Luçi, për trajtimin dhe vendimmarrjen, lidhur me kërkesat për akordimin e shpërblimit të menjëhershëm dhe pagesave kalimtare, sipas ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore në fuqi.

2. Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Financave, për çështjen e përcaktuar në pikën 1 (një) të këtij urdhri, do të ushtrohen nga data e hyrjes në fuqi, deri në shfuqizimin e tij.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Financave, z. Erjon Luçi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Helga Vukaj

URDHËR
Nr. 67, datë 20.6. 2017

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të neneve 28, 29 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012

“Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Financave, zëvendësministrit të Ministrisë së Financave, znj. Irena Beqiraj, për trajtimin dhe vendimmarrjen, lidhur me masën e llogaritur të shpërndarjes së të ardhurave nga renta minerale, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore në fuqi, që rregullojnë këtë çështje.

2. Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Financave, për çështjen e përcaktuar në pikën 1 (një) të këtij urdhri, do të ushtrohen nga data e hyrjes në fuqi, deri në shfuqizimin e tij.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Financave, znj. Irena Beqiraj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Helga Vukaj

URDHËR
Nr. 69, datë 29.6.2017

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të neneve 28, 29 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Financave, zëvendësministrit të Ministrisë së Financave, z. Erjon Luçi, për trajtimin dhe vendimmarrjen lidhur me kërkesat për rialokim fondesh, sipas parashikimeve të legjislacionit buxhetor në fuqi.

2. Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Financave, për çështjen e përcaktuar në pikën 1



(një) të këtij urdhri, do të ushtrohen nga data e hyrjes në fuqi, deri në shfuqizimin e tij.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Financave, z. Erjon Luçi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare

MINISTRI I FINANCAVE
Helga Vukaj

URDHËR
Nr. 71, datë 3.7. 2017

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të neneve 28, 29 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Financave, zëvendësministrit të Ministrisë së Financave, z. Erjon Luçi, për trajtimin dhe vendimmarrjen, lidhur me kërkesën nr. 8172/4 Prot., datë 29.5.2017, të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, me objekt rialokim fondesh, sipas parashikimeve të legjislacionit buxhetor në fuqi.

2. Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Financave, për çështjen e përcaktuar në pikën 1 (një) të këtij urdhri, do të ushtrohen nga data e hyrjes në fuqi, deri në shfuqizimin e tij.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Financave, z. Erjon Luçi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Helga Vukaj

URDHËR

Nr. 72, datë 3.7.2017

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të neneve 28, 29 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Financave, zëvendësministrit të Ministrisë së Financave, z. Erjon Luçi, për trajtimin e praktikës mbi Draftmarrëveshjen e Grantit për Asistencë Teknike, të propozuar nga Fondi i Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab.

2. Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Financave, për çështjen e përcaktuar në pikën 1 (një) të këtij urdhri, do të ushtrohen nga data e hyrjes në fuqi, deri në shfuqizimin e tij.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Financave, z. Erjon Luçi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Helga Vukaj

URDHËR

Nr. 75, datë 6.7.2017

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të neneve 28, 29 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,



URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Financave, zëvendësministrit të Ministrisë së Financave, z. Erjon Luçi, për trajtimin e praktikës nr. 3568/1 Prot., datë 30.6.2017, të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, me objekt rialokimin e fondeve në buxhetin e investimeve të vitit 2017, për programin “Furnizimi me ujë dhe kanalizime”, sipas parashikimeve të legjislacionit buxhetor në fuqi.

2. Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Financave, për çështjen e përcaktuar në pikën 1 (një) të këtij urdhri, do të ushtrohen nga data e hyrjes në fuqi, deri në shfuqizimin e tij.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Financave, z. Erjon Luçi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Helga Vukaj

URDHËR

Nr. 78, datë 12.7.2017

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të neneve 28, 29 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Financave, zëvendësministrit të Ministrisë së Financave, z. Erjon Luçi, për trajtimin e praktikës nr. 4797 Prot, datë 19.6.2017, të ALUIZNI-t, me objekt “Kalimin në Fondin Special të kompensimit të pronarëve të të ardhurave të arkëtuara nga transferimi i pronës së parcelës ndërtimore për periudhën 1.1.2017 - 31.5.2017”, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

2. Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Financave, për çështjen e përcaktuar në pikën 1 (një) të këtij urdhri, do të ushtrohen nga data e hyrjes në fuqi, deri në shfuqizimin e tij.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Financave, z. Erjon Luçi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Helga Vukaj

URDHËR

Nr. 82, datë 19.7.2017

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të neneve 28, 29 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Financave, zëvendësministrit të Ministrisë së Financave, z. Erjon Luçi, për trajtimin e praktikës nr. 8665/1 Prot, datë 13.6.2017, të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, me objekt depozitimin e firmave të autorizuara për programin “Menaxhimi i mbetjeve të ngurta në Vlorë”. Marrëveshja e Huas me vlerë 12.000.000.00 euro.

2. Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Financave, për çështjen e përcaktuar në pikën 1 (një) të këtij urdhri, do të ushtrohen nga data e hyrjes në fuqi, deri në shfuqizimin e tij.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Financave, z. Erjon Luçi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Helga Vukaj

**URDHËR****Nr. 83, datë 19.7.2017****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të neneve 28, 29 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Financave, zëvendësministrit të Ministrisë së Financave, z. Erjon Luçi, për trajtimin e praktikës nr. 10036/1, datë 13.7.2017, të Shoqatës së Invalidëve Para & Tetraplegjik të Shqipërisë, me objekt “Përjashtimin e mjeteve e pajisjeve nga taksat doganore”.

2. Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Financave, për çështjen e përcaktuar në pikën 1 (një) të këtij urdhri, do të ushtrohen nga data e hyrjes në fuqi, deri në shfuqizimin e tij.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Financave, z. Erjon Luçi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Helga Vukaj

URDHËR**Nr. 84, datë 24.7.2017****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të neneve 28, 29 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Financave, zëvendësministrit të Ministrisë së Financave, z. Erjon Luçi, për trajtimin e praktikave të ardhura nga programi IADSA me nr. 73 Prot., datë 31.5.2017, “Për kalimin e kështit të katërt, Ministria e Shëndetësisë, nr. 80 Prot., datë 1.6.2017, “Për kalimin e kështit të dytë bashkia Libohovë”, nr. 79 Prot., datë 1.6.2017, “Për kalimin e kështit të dytë, bashkia Cërrik”, nr. 82 Prot., datë 7.6.2017, “Për modifikim buxheti, bashkia Libohovë”, nr. 72 Prot., datë 31.5.2017, “Për kalim kështit të tretë, bashkia Elbasan”, nr. 96 Prot., datë 7.7.2017, “Zgjatje projekti, Ministria e Ekonomisë”, nr. 74 Prot., datë 31.5.2017, “Ndryshim buxheti, Ministria e Ekonomisë”, nr. 98 Prot., datë 13.7.2017, “Për kalimin e kështit të 4-t, Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike”.

2. Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Financave, për çështjen e përcaktuar në pikën 1 (një) të këtij urdhri, do të ushtrohen nga data e hyrjes në fuqi, deri në shfuqizimin e tij.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Financave, z. Erjon Luçi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare

MINISTRI I FINANCAVE
Helga Vukaj

URDHËR**Nr. 85, datë 25.7.2017****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të neneve 28, 29 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Financave, zëvendësministrit të



Ministresë së Financave, z. Erjon Luçi, për trajtimin e praktikës së ardhur nga Ministria e Kulturës me nr. 9417/3 Prot., datë 24.7.2017, “Për transferimin e fondeve në buxhetin e investimeve të vitit 2017, për institucionin e Bibliotekës Kombëtare”.

2. Kompetencat e titullarit të Ministresë së Financave, për çështjen e përcaktuar në pikën 1 (një) të këtij urdhri, do të ushtrohen nga data e hyrjes në fuqi, deri në shfuqizimin e tij.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Ministresë së Financave, z. Erjon Luçi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare

MINISTRI I FINANCAVE
Helga Vukaj

URDHËR

Nr. 86, datë 27.7.2017

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të neneve 28, 29 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministresë së Financave, zëvendësministrit të Ministresë së Financave, z. Erjon Luçi, për trajtimin e praktikës nr. 7244/1 Prot., datë 19.5.2017, dërguar nga z. Etjen Xhafaj, me subjekt “Kërkesë për pagesë suplementare dhe pagesë kalimtare”.

2. Kompetencat e titullarit të Ministresë së Financave, për çështjen e përcaktuar në pikën 1 (një) të këtij urdhri, do të ushtrohen nga data e hyrjes në fuqi, deri në shfuqizimin e tij.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Ministresë së Financave, z. Erjon Luçi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Helga Vukaj

URDHËR

Nr. 87, datë 27.7.2017

**PËR SHFUQIZIMIN E AKTIT NR. 16,
DATË 11.7.2017, “PËR NDRYSHIME NË
PËRBËRJEN E KËSHILLIT
MBIKËQYRËS TË “AGJENCISË SË
TRAJTIMIT TË KREDIVE”**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës e në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e aktit nr. 16, datë 11.7.2017, “Për ndryshime në përbërjen e Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë së Trajtimit të Kredive”.

2. Depozitimin e këtij urdhri në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Agjencia e Trajtimit të Kredive.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Helga Vukaj

URDHËR

Nr. 89, datë 28.7.2017

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të neneve 28, 29 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministresë së Financave, zëvendësministrit të Ministresë së Financave, z. Erjon Luçi, për



trajtimin e praktikës së ardhur nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës me nr. 10808 Prot., datë 27.7.2017, “Për transferimin e fondeve në buxhetin e investimeve të vitit 2017, për programin e transportit rrugor”.

2. Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Financave, për çështjen e përcaktuar në pikën 1 (një) të këtij urdhri, do të ushtrohen nga data e hyrjes në fuqi, deri në shfuqizimin e tij.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Financave, z. Erjon Luçi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare

MINISTRI I FINANCAVE
Helga Vukaj

URDHËR
Nr. 251, datë 27.7.2017

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të shkronjës “d” të nenit 28 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të neneve 28, 29 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të pikës 3 të nenit 15, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave administrative që zotëron z. Alqi Bllako, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Drejtorit të Drejtorisë Juridike, Komunikimit dhe Prokurimeve, znj. Alba Thoma.

2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga znj. Alba Thoma, Drejtor i Drejtorisë Juridike, Komunikimit dhe Prokurimeve nga data 27.7.2017.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet z. Alqi Bllako, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe znj. Alba Thoma, Drejtor i Drejtorisë Juridike, Komunikimit dhe Prokurimeve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT
Lefter Koka

NJOFTIM I MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME

Nr. 10937, datë 26.7.2017

MBI HYRJEN NË FUQI TË DISA MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE

1. Në datën 29 maj 2017 kanë hyrë në fuqi marrëveshjet ndërkombëtare si vijon:

- Marrëveshja me shkëmbim notash ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për projektin: “Mbështetje për harmonizimin e legjislacionit ekonomik dhe tregtar me aktet nënligjore të BE-së”.

- Marrëveshja me shkëmbim notash ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për projektin: “Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe rajonal, nxitja e punësimit dhe arsimit profesional”.

- Marrëveshja me shkëmbim notash ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për projektin: “Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe rajonal, nxitja e punësimit dhe arsimit profesional (shtesë fondesh)”.

- Marrëveshja me shkëmbim notash ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për projektin: “Zhvillimi i qëndrueshëm i integruar i rajonit bregdetar”.

- Marrëveshja me shkëmbim notash ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për projektin: “Menaxhimi i integruar i mbetjeve të ngurta dhe ekonomia ricikluese në respekt të mjedisit në Shqipëri”.

- Marrëveshja me shkëmbim notash ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për projektin: “Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe rajonal, nxitja e punësimit dhe arsimit profesional”.

- Marrëveshja me shkëmbim notash ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për projektin: “Ruajtja e agrobiodiversitetit në Shqipërinë rurale”.



2. Në datën 7 qershor 2017 kanë hyrë në fuqi marrëveshjet ndërkombëtare si vijon:

- Marrëveshja me shkëmbim notash ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për projektin: “Fondi për studime dhe ekspertë”.

- Marrëveshja me shkëmbim notash ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për projektin: “Shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të orientuara drejt konsumatorit dhe performancës”.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Gazmend Barbullushi

NJOFTIM I MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME

Nr. 11211, datë 31.7.2017

MBI HYRJEN NË FUQI TË MARRËVESHJES ME ITALINË

Në datën 27 korrik 2017 ka hyrë në fuqi “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për programin “Në mbështetje të arsimit dhe formimit profesional (AFP) nëpërmjet inovacionit””.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Gazmend Barbullushi

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 84 lekë